



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.250/2 prot.

Datë 01.02.2024

V E N D I M

Nr. 126/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1256/2023, datë 05.12.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “*Rikonstruktion Lulishtesh*”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntëmilion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Ankimues: “TEA-D” SHPK me NIPT K32522629L dhe adresë Gjirokastër, Libohovë, Rruga “Dhuvjan”, nr. pasurie 3105, ZK 2444.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit me adresë Rruga “5 Maji”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 05.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1256/2023, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “TEA-D” SHPK dhe “COGREN” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, Pune, me mjete elektronike” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “TEA-D” SHPK dhe “COGREN” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “TEA-D” SHPK dhe “COGREN” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
8. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 1702/40 prot., datë 27.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2770/14 prot., datë 28.12.2023 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur”, Pune, me mjete elektronike” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Autoriteti kontraktor referuar vendimit përfundimtar të KPP-së nr.1256/2023 me datë 05.12.2023, bazuar në nenin 118 pika 2/b të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar udhëzimit nr.07 datë 31.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” nga nënpunësi i autorizuar i sistemit në rastin e një vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik ka vepruar duke zbatuar vendimin e sipërcituar me urdhër të titullarit të AK “Heqje pezullimi” nr. 1702/30 prot., datë 14.12.2023 pas protokollimit të vendimit të KPP-së duke klikuar tek butoni “Fillo Ri-Vlerësimin” me qëllim kthimin e procedurës në skedarin “Për tu vlerësuar” nga anëtarët e KVO-së. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura të Ri-vlerësimit me nr. 1702/31 prot., datë 15.12.2023 nga dy anëtarët e KVO-së dhe nr.2832 prot., datë 18.12.2023 nga kryetari i KVO-së, të cilët kanë kryer vlerësimin në SPE në mënyrë të pavarur duke zbatuar vendimin 1256/2023 datë 05.12.2023 si dhe me vendim unanim kanë dërguar datë 18.12.2023 Raportin përmbledhës të miratuar nga Titullari i AK mbi vendimmarrjen e tyre në lidhje me Ri-vlerësimin e përfunduar dhe të nënshkruar nga të tre anëtarët e KVO-së. Menjëherë në të njëjtën datë 18.12.2023 është ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formulari i Njoftimit të Anulimit me nr.1702/34 prot., datë 18.12.2023 i publikuar nga APP më datë 19.12.2023 dhe të pasqyruar në Buletinin Nr.103 datë 26.12.2023 bazuar në urdhërin e anulimit të procedurës nr. 1702/33 prot., datë 18.12.2023.

Sa i përket rihedhjes sërisht të procedurës "E hapur, punë" me objekt "Rikonstruksion Lulishtesh", referuar vendimit nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" siç është shprehur shkresërisht edhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit drejtuar sektorit të prokurimit me anë të shkresës nr.2886 datë 27.12.2023 ku na informon që ky fond sipas PBA së miratuar 2023-2025 është parashikuar për tu zhvilluar dhe likuiduar brenda vitit buxhetor 2023. Në momentin e rihedhjes rishtazi nga autoriteti kontraktor kjo procedurë prokurimi me të njëjtin objekt sipërcituar, menjëherë do të dërgohet KPP-së i gjithë dokumentacioni i kërkuar i procedurës (DST dhe Njoftimi i kontrtaës) me modifikimet në përputhje me konstatimet e KPP-së të shprehura në vendimin nr.1256/2023 datë 05.12.2023".

I.3. Në datë 20.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1328/2023, ku vendosi:

- 1. Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur, mallra" me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: "Rikonstruksion Lulishtesh", me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.*
- 2. Autoriteti kontraktor të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës që do të ripublikojë, të modifikuara në përputhje me konstatimet e KPP-së të shprehura në vendimin Nr. 1256/2023, datë 05.12.2023.*
- 3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
- 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr. 1702/40 prot., datë 27.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2770/14 prot., datë 28.12.2023 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit "E hapur", Pune, me mjete elektronike" me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: "Rikonstruksion Lulishtesh", me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Autoriteti kontraktor referuar vendimit përfundimtar të KPP-së nr.1256/2023 me datë 05.12.2023, bazuar në nenin 118 pika 2/b të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" si dhe referuar udhëzimit nr.07 datë 31.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike" nga nënpunësi i autorizuar i sistemit në rastin e një vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik ka vepruar duke zbatuar vendimin e sipërcituar me urdhër të titullarit të AK "Heqje pezullimi" nr. 1702/30 prot., datë 14.12.2023 pas protokollimit të vendimit të KPP-së duke klikuar tek butoni "Fillo Ri-Vlerësimin" me qëllim kthimin e procedurës në skedarin "Për tu vlerësuar" nga anëtarët e KVO-së. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura të Ri-vlerësimit me nr. 1702/31 prot., datë 15.12.2023 nga dy anëtarët e KVO-së dhe nr.2832 prot., datë 18.12.2023 nga kryetari i KVO-së, të cilët kanë kryer vlerësimin në SPE në mënyrë të pavarur duke zbatuar vendimin 1256/2023 datë 05.12.2023 si dhe me vendim unanim kanë dërguar datë 18.12.2023 Raportin përmbledhës të miratuar nga Titullari i AK mbi vendimmarrjen e tyre në lidhje me Ri-vlerësimin e përfunduar dhe të nënshkruar nga të tre anëtarët e KVO-së. Menjëherë në të njëjtën datë 18.12.2023 është ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formulari i Njoftimit të Anulimit me nr.1702/34 prot.,

datë 18.12.2023 i publikuar nga APP më datë 19.12.2023 dhe të pasqyruar në Buletinin Nr.103 datë 26.12.2023 bazuar në urdhërin e anulimit të procedurës nr. 1702/33 prot., datë 18.12.2023. Sa i përket rihedhjes sërisht të procedurës "E hapur, punë" me objekt "Rikonstruksion Lulishtesh", referuar vendimit nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" siç është shprehur shkresërisht edhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit drejtuar sektorit të prokurimit me anë të shkresës nr.2886 datë 27.12.2023 ku na informon që ky fond sipas PBA së miratuar 2023-2025 është parashikuar për tu zhvilluar dhe likuiduar brenda vitit buxhetor 2023. Në momentin e rihedhjes rishtazi nga autoriteti kontraktor kjo procedurë prokurimi me të njëjtin objekt sipërcituar, menjëherë do ti dërgohet KPP-së i gjithë dokumentacioni i kërkuar i procedurës (DST dhe Njoftimi i kontrtaës) me modifikimet në përputhje me konstataimet e KPP-së të shprehura në vendimin nr.1256/2023 datë 05.12.2023".

I.5. Në datë 29.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1383/2023, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur, mallra" me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: "Rikonstruksion Lulishtesh", me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.6. Me shkresën nr. 7/1 prot., datë 04.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2770/18 prot., datë 08.01.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit "E hapur", Pune, me mjete elektronike me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: "Rikonstruksion Lulishtesh", me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit. [...Për të gjitha konkluzionet e arritura nga KPP-ja me anë të vendimit nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 anëtarët e KVO-së kanë kryer në sistem ndryshimet përkatëse për të gjitha pikat ku vendimi është shprehur se pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "TEA-D" SHPK dhe "COGREN" SHPK qëndronin dhe që janë në kompetencë të anëtarëve të KVO-së..].

I.7. Në datë 09.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 30/2024, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur" me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: "Rikonstruksion Lulishtesh", me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.8. Me shkresën nr. 7/4 prot., datë 16.01.2024, protokolluar me tonën nr. 36/3 prot., datë 18.01.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur”, Pune, me mjete elektronike” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

I.9. Në datë 19.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 63/2024, ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.10. Me shkresën nr. 7/7 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 36/8 prot., datë 31.01.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik. Ndër të tjera citoj:

[...2.2. Në lidhje me zbatueshmërinë e pikës 2 të dispozitivit referuar Vendimit me nr. 63/2024 datë 19.01.2024 në përputhje me konstatimet në Vendimin nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 të KPP-së, me anë të shkresës nr.7/4 prot., datë 16.01.2024 kthim përgjigje KPP-së bashkëlidhur relacionin shpjegues me nr. 7/3 prot., datë 16.01.2024 nga 2 (dy) anëtarët e KVO-së është detajuar qartazi referuar 4 (katër) pikave kryesore nga të cilat 2 (dy) prej tyre janë reflektuar ndryshimet në SPE konkretisht “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5. si dhe pika 1.b. sa i përket sigurimit të Ofertës, sipas shtojcës 3; ku të 2 (dy) anëtarët e KVO-së e kanë reflektuar si të mirëqenë faktin që është uploaduar/ngarkuar në SPE dhe si e tillë Sigurimi i Ofertës është konsideruar si i vlefshëm me qëllim respektimin e Vendimit nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 të KPP-së. Për të dyja këto pikat vendimi i KPP-së nr.1256/2023 datë 05.12.2023 është zbatuar pasi ka qënë edhe në vendim i shprehur qartë duke u cituar se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron dhe për këtë qëllim konsiderohet i përmbushur. Referuar kriterit që i përket pikës 2.3.14 Procesverbali i paraqitur nga bashkimi i OE ankimes “TEA-D” SHPK & “COGREN” SHPK nuk është protokolluar pranë zyrave të DPPGJ-së si dhe pikës 2.3.15 kriterit për mosparaqitjen e mostrave përpara zhvillimit të tenderit sipas procesverbalit të mbajtur në datë 13.10.2023 prot., 1702/14, vendimi i KPP-së nr.1256/2023 datë 05.12.2023 nuk është i shprehur nëse qëndron apo nuk qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, siç është shprehur apo cituar për pikat e tjera, por ka gjykuar se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi. Për sa më sipër si dhe në zbatim të nenit 75 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” 2 (dy) anëtarët e tjerë të KVO-së

nuk kanë reflektuar ndryshimet në SPE për pikat e sipërcituara (pika 2.3.14 dhe 2.3.15 mosparaqitja e mostrave të DST-ve), pasi vendimi i KPP-së nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 nuk shprehet qartazi nëse pretendimet e OE qëndrojnë apo nuk qëndrojnë për këto dy pika sikundër është shprehur për pikat e tjera të kritereve teknike.

Kërkojmë rishtazi të na qartësoni nëse pikat e kriterit teknik 2.3.14 procesverbali i paraqitur nuk është protokolluar pranë zyrave të DPPGJ-së dhe 2.3.15 mosparaqitja e mostrave përpara zhvillimit të tenderit nga operatori ekonomik ankimues qëndrojnë apo nuk qëndrojnë për të përmbushur plotësisht pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr.60/2024 datë 19.01.2024 pasi në të 4 vendimet e dërguara nga ana juaj është po i njëjti qëndrim i paqartë dhe jo i plotë mbi veprimet që duhet të ndërmarin 2 (dy) anëtarët e KVO-së....]

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 7/7 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 36/8 prot., datë 31.01.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1256/2023 , datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik. Ndër të tjera citoj:

[...2.2. Në lidhje me zbatueshmërinë e pikës 2 të dispozitivit referuar Vendimit me nr. 63/2024 datë 19.01.2024 në përputhje me konstatimet në Vendimin nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 të KPP-së, me anë të shkresës nr.7/4 prot., datë 16.01.2024 kthim përgjigje KPP-së bashkëlidhur relacionin shpjegues me nr. 7/3 prot., datë 16.01.2024 nga 2 (dy) anëtarët e KVO-së është detajuar qartazi refruar 4 (katër) pikave kryesore nga të cilat 2 (dy) prej tyre janë reflektuar ndryshimet në SPE konkretisht “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5. si dhe pika 1.b. sa i përket sigurimit të Ofertës, sipas shtojcës 3; ku të 2 (dy) anëtarët e KVO-së e kanë reflektuar si të mirëqenë faktin që është uploaduar/ngarkuar në SPE dhe si e tillë Sigurimi i Ofertës është konsideruar si i vlefshëm me qëllim respektimin e Vendimit nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 të KPP-së. Për të dyja këto pikat vendimi i KPP-së nr.1256/2023 datë 05.12.2023 është zbatuar pasi ka qenë edhe në vendim i shprehur qartë duke u cituar se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe për këtë qëllim konsiderohet i përmbushur. Referuar kriterit që i përket pikës 2.3.14 Procesverbali i paraqitur nga bashkimi i OE ankimues “TEA-D” SHPK & “COGREN” SHPK nuk është protokolluar pranë zyrave të DPPGJ-së si dhe pikës 2.3.15 kriterit për mosparaqitjen e mostrave përpara zhvillimit të tenderit sipas procesverbalit të mbajtur në datë 13.10.2023 prot., 1702/14, vendimi i KPP-së nr.1256/2023 datë 05.12.2023 nuk është i shprehur nëse qëndron apo nuk qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, siç është shprehur apo cituar për pikat e tjera, por ka gjykuar se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi. Për sa më sipër si dhe në zbatim të nenit 75 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” 2 (dy) anëtarët e tjerë të KVO-së nuk kanë reflektuar ndryshimet në SPE për pikat e sipërcituara (pika 2.3.14 dhe 2.3.15 mosparaqitja e mostrave të DST-ve), pasi vendimi i KPP-së nr. 1256/2023 datë 05.12.2023 nuk shprehet qartazi nëse pretendimet e OE qëndrojnë apo nuk qëndrojnë për këto dy pika sikundër është shprehur për pikat e tjera të kritereve teknike.

Kërkojmë rishtazi të na qartësoni nëse pikat e kriterit teknik 2.3.14 procesverbali i paraqitur nuk është protokolluar pranë zyrave të DPPGJ-së dhe 2.3.15 mosparaqitja e mostrave përpara zhvillimit të tenderit nga operatori ekonomik ankimes qëndrojnë apo nuk qëndrojnë për të përmbushur plotësisht pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr.60/2024 datë 19.01.2024 pasi në të 4 vendimet e dërguara nga ana juaj është po i njëjti qëndrim i paqartë dhe jo i plotë mbi veprimet që duhet të ndërmarin 2 (dy) anëtarët e KVO-së....].

II.1.1. Në vijim të komunikimit me institucionin tuaj dhe për sa më lartë keni kërkuar sqarime në lidhje me zbatimin e plotë të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, Komisioni ju sqaron se:

- i. Në pikën III.1., të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.5 të dokumentave standarde të tenderit, për të cilin autoriteti kontraktor ka skualifikuar në fillim bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, nga shqyrtimi i pretendimit të këtij të fundit, Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimin e tij. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, e nuk kanë reflektuar në mënyrë unanime në ri-vlerësim, në sistemin e prokurimit elektronik. Ky veprim, duhet të pasqyrohet në të tre seksionet (dokumentacioni provues, financiar dhe teknik) nga të tre Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- ii. Në pikën III.2., të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.1.b. të dokumentave standarde të tenderit, për të cilin autoriteti kontraktor ka skualifikuar në fillim bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, nga shqyrtimi i pretendimit të këtij të fundit, Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimin e tij. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, e kanë reflektuar në mënyrë unanime në ri-vlerësim, në sistemin e prokurimit elektronik, vetëm dy prej tyre. Ky veprim, duhet të pasqyrohet në të tre seksionet (dokumentacioni provues, financiar dhe teknik) nga të tre Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- iii. Në pikën III.3., të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.14 të dokumentave standarde të tenderit, për të cilin autoriteti kontraktor ka skualifikuar në fillim bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, nga shqyrtimi i pretendimit të këtij të fundit, Komisioni është ndalur në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, mbi hartimin e kriteri në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve në fuqi, duke i kërkuar këtij të fundit anulimin e procedurës së prokurimit dhe mbajtjes në konsideratë në rast të ri-shpalljes së kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në momentin e ri-vlerësimit, duhet të heqë arsyen e skualifikimit të shprehur për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, për sa kohë që është një kriter i hartuar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe për të cilin është kërkuar edhe anulimi i procedurës së prokurimit. Ky veprim, duhet të pasqyrohet në të tre seksionet (dokumentacioni provues, financiar dhe teknik) nga të tre Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- iv. Në pikën III.4., të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.15 të dokumentave standarde të tenderit, për të cilin autoriteti kontraktor ka skualifikuar në fillim bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, nga shqyrtimi i pretendimit të këtij të fundit, Komisioni është ndalur në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, mbi hartimin e kriteri në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve në fuqi, duke i kërkuar këtij të fundit anulimin e procedurës së prokurimit dhe mbajtjes në konsideratë në rast të ri-shpalljes së kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në momentin e ri-vlerësimit, duhet të heqë arsyen e skualifikimit të shprehur për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, për sa kohë që është një kriter i hartuar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe për të cilin është kërkuar edhe anulimi i procedurës së prokurimit. Ky veprim, duhet të pasqyrohet në të tre seksionet (dokumentacioni provues, financiar dhe teknik) nga të tre Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- v. Në pikën III.5., të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.1 të dokumentave standarde të tenderit, për të cilin autoriteti kontraktor ka skualifikuar në fillim bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes, nga shqyrtimi i pretendimit të këtij të fundit, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë pretendimin e tij. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit KPP 1256/2023 datë 05.12.2023, e kanë reflektuar në mënyrë unanime në ri-vlerësim, në sistemin e prokurimit elektronik, vetëm dy prej tyre. Ky veprim, duhet të pasqyrohet në të tre seksionet (dokumentacioni provues, financiar dhe teknik) nga të tre Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor nuk ka kryer rivlerësimin për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në përputhje me konstatimet në vendimet KPP. 1256/2023 datë 05.12.2023, duke rivlerësuar bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të këtij vendimi. Pra, nuk është bërë një zbatim i drejtë dhe korrekt i vendimit KPP. 1256/2023.

Konkretisht nuk është zbatuar plotësisht pika e dispozitivit:

- *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “TEA-D” SHPK dhe “COGREN” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*

pasi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Oferta nuk kanë kryer vlerësimin në mënyrë unanime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në përputhje me konstatimet në vendimin KPP.1256/2023, datë 05.12.2023, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1256/2023,

datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

